



Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të neneve 3.5 pika (i), 15.1 pika (a), (c), (e), (j) lidhur me nenin 45 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Viti III, Nr. 28, datë 4 qershor 2008),

Duke marrë parasysh,

Obligimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës në lidhje me Marrëveshjen Shumëpalëshe për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (më tutje referuar si "Marrëveshja për HPEA") që nga hyrja e saj e përkohshme në fuqi për Kosovën më 10 tetor 2006,

Rregulloren e AAC-së nr. 4/2015 mbi kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me operimet ajrore me të cilën është shfuqizuar rregullorja e AAC-së Nr. 9/2011 e datës 28 shtator 2011,

Me qëllim të implementimit të Rregullores së Komisionit (EC) Nr. 474/2006 të datës 22 mars 2006 për themelimin e listës së Komunitetit të transportuesve ajror të cilët i nënshtrohen ndalimit të operimeve brenda Komunitetit të referuar në Kapitullin II të Rregullores (EC) Nr. 2111/2005 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës,

Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik me të gjitha palët e interesuara në pajtim me Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2012 për konsultimin publik të palëve të interesuara,

Nxjerr këtë:

RREGULLORE NR. 12/2015
PËR THEMELIMIN E LISTËS SË KOMUNITETIT TË TRANSPORTUESVE AJROR
TË CILËT I NËNSHTROHEN NDALIMIT TË OPERIMEVE BREND
KOMUNITETIT

Neni 1

1.1 Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 474/2006 të datës 22 mars 2006 për themelimin e listës së Komunitetit të transportuesve ajror të cilët i nënshtrohen ndalimit të operimeve brenda Komunitetit të referuar në Kapitullin II të Rregullores (EC) Nr. 2111/2005 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, me tutje e referuar si "Rregullorja e Komisionit", shpallet e zbatueshme në Republikën e Kosovës. Rregullorja e Komisionit i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje si shtojcë dhe formon pjesën e saj përbërëse.

1.2 Dispozitat e zbatueshme të Rregullores së Komisionit në Republikën e Kosovës janë Nenet 1 deri 3, Shtojcat A dhe B.

1.3 Çdo dispozitë e amandamenteve të ardhshme të Rregullores së Komisionit, me futjen e saj në fuqi si pjesë e Shtojcës I ose II të Marrëveshjes për HPEA, do të jetë e zbatueshme drejtpërsëdrejti në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Kuptimi i shprehjeve dhe definicionet "Komuniteti", "ligji i Komunitetit", "legjislacioni i Komunitetit", "Instrumentet e Komunitetit", "Traktati i KE", "aerporti i Komunitetit", "Gazeta Zyrtare e Komuniteteve Evropiane", "Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian", "transportues ajror i Komunitetit" dhe "Shtet(e) Anëtar(e)", të cilat mund të referohen në mënyre të drejtpërdrejt ose tërthorazi në Rregulloren e Komisionit, duhet të lexohen në përputhje me Pikat 2 dhe 3 të Shtojcës II të Marrëveshjes për HPEA.

Neni 3

Zbatimi i dispozitave të Rregullores së Komisionit që lidhen me funksionet dhe detyrat e EASA-së të cilat kryhen në emër të Shteteve Anëtare, sa i përket Republikës së Kosovës do të jenë subjekt i aranzhimeve të punës ndërmjet EASA dhe Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës.

Neni 4

Në rast të interpretimit të Rregullores së Komisionit, do të përdoret versioni origjinal në gjuhën angleze siç është i publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Neni 5

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 20 nëntor 2015.

Prishtinë, 6 nëntor 2015.

Dritan Gjonbalaj
Drejtor i Përgjithshëm